

Living

Dimër 2025 Nr.69

**Anita
Likmeta**
the "Unstoppable
Woman"



**"Le favole del
comunismo",
romani i parë më i
vlerësuar dhe më i
shitur në Itali**

Anita Likmeta

the “Unstoppable Woman”;

“Le favole del comunismo”, romani i parë
më i vlerësuar dhe më i shitur në Itali



Nga : Santana Çomora
Set Coordinator: Aurora Vacanti
(Instagram @goddessofdiscord)
Photographer: Marco Coniglione
(Instagram @marcoconiglione)
Make-up: Carlotta Bellanuova
(Instagram @itslottie.mua)
Hairstylist: Davide Racini
(@dar___milano)
Dizajni Grafik: Aldo Beshiri
Studio: DA\R Milano

Anita Likmeta është një personazh aq i njohur, po aq sa dhe i panjohur për lexuesin shqiptar. Me vite të tëra të jetuara në Itali, ajo ka ditur të ndërtojë një profil dinjitoz dhe mjaft të arrirë si sipërmarrëse italo-shqiptare, duke u vlerësuar si një nga 150 gratë më të fuqishme në inovacion në Itali. Njëkohësisht, ajo është kandidatja e parë shqiptare që ka konkurruar për Dhomën e Deputetëve të Parlamentit Italian në zgjedhjet parlamentare.

Letërsia e vërtetë
vihet në shërbim të
tjetrit, i hapet botës
dhe zhvishet nga
vetvetja. Pikërisht
aty qëndron vlera
e saj, dhe pikërisht
aty përpiqen të
pozicionohen edhe
“Le favole del
comunismo”.



Para se të mbërrijmë tek Anita e ditëve të sotme do doja të ndalesha tek ajo Anita e vogël, me sytë e kristaltë, vajzën nga Durrësi që kujtimet me këtë vend nuk i ka dhe aq të mira. Fëmijëria e saj ishte një poezi e heshtur, një kohë e mbështjellë me thjeshtësinë dhe qetësinë e fshatit, ku u rrit nën kujdesin e gjyshërve në Rrubjekë, një fshat i vogël në prefekturën e Durrësit. Aty nisi dhe udhëtimi i saj drejt dijes, në një shkollë të thjeshtë. Çdo gjë ishte e zhveshur nga tepria, por e mbushur me një kuptim të thellë. Ka jetuar njëmbëdhjetë vjet e gjysmë larg nënës, dhe kjo kohë, ndonëse e mbushur me dashuri, ka lënë gjurmë të thella në formësimin e saj. Që nga lindja, ishte nën kujdesin e gjyshërve, figura që për të mishëronjë stabilitetin, urtësinë dhe ngrohtësinë e përditshmërisë. Megjithatë, figura e nënës nuk i mungoi kurrë, as në distancë. Ishte një prani e ndjeshme, gati arketipore, që e shoqëronte në heshtje.

- "Mbaj mend se si, si fëmijë, e kërkoja në ëndrra, e thërrisja në thellësinë e natës, duke shpresuar ta gjeja në sytë e grave të tjera që takoja. Por e dija që, herët a vonë, do ta përqafoja, sepse një nënë nuk është thjesht mish dhe gjak: ajo është një ide, një ndjenjë, një rrahje e përjetshme që nuk njeh kufij

"- thotë Anita.

Pak kohë më vonë erdhi dita kur do të jetonte në Durrës me tezen e saj. Ishte si të bënte një hap drejt së ëmës: deti që e ndante i dukej më pak një kufi dhe më shumë një urë që e lidhte. Në Durrës mbaroi shkollën fillore "Marie Kaçulini," një vend që mbante emrin e një figure femërore të fuqishme, një simbol i arsimit dhe emancipimit. Jeta në qytet ishte ndryshe: më e shpejtë, më e zhurmshme, por e mbushur me histori dhe kulturë. Të ecte nëpër rrugët e këtij qyteti bregdetar me histori, ku ndihej kalimi i qytetërimeve – romake, veneciane, osmane – ishte si të ecte mes faqeve të një libri të hapur. Por, sado i gjallë të ishte Durrësi, mendimet e saja shpesh ktheheshin në fushat e Rrubjekës, te ajo fëmijëri e ndërtuar nga ritmet e tokës dhe urtësia e qetë e gjyshërve të saj. Pikërisht, në këtë ambient mësoi jo vetëm të lexonte dhe të shkruante, por edhe të vështronte dhe të dëgjonte, të gjente tek përditshmëria farën e diçkaje më të madhe. Ky ekuilibër mes paqes së fshatit dhe gjallërisë së qytetit e formoi, duke hedhur themelet për gjithçka që ajo është sot. Rrubjeka i mësoi ngadalësinë e nevojshme për të kuptuar, Durrësi i dha horizontin për të ëndërruar, dhe deti, ai det që e ndante nga nëna, e mësoi të jetonte me shpresën se çdo dis-

tancë, në fund, mund të kapërcehet.

Tek flet për gjyshërit ndihet që dashuria sublime për ta ka qenë dhe mbetet ushqimi kryesor i jetësimit të saj:

"Ishin njerëz të thjeshtë, por të pajisur me një mençuri të jashtëzakonshme, atë lloj mençurie që lind nga lidhja e thellë me tokën dhe kohën. Gjyshi im ishte ndërtues urash, dhe jo vetëm në kuptimin e drejtpërdrejtë: jeta e tij ishte një urë mes brezave, një pikë referimi për të gjithë ata që e njihnin. Fliste pak, por çdo fjalë e tij ishte e saktë, gati e mprehtë në thellësinë e saj. Ai ishte një njeri që mishëronte urtësinë e lashtë, atë që nuk ka nevojë të shfaqet me bujë, por që rrjedh ngadalë, si një rrjedhë e fshehur që formëson peizazhin, ndërsa gjyshja ishte qendra e shtëpisë, zjarri rreth të cilit rrotullohej gjithçka."

Të dy gjyshërit e rritën me dashuri dhe qëndrueshmëri, duke i mësuar vlerën e heshtjes, të punës dhe të durimit. Dashuria e nënës nga ana tjetër, ishte një dashuri që i përkiste mbretërisë së ideve, sferës së simbolikës: larg, por gjithnjë e pranishme, një fije e padukshme që e mbannte të lidhur me të, kudo që të ishte. Ky dualitet, mes konkretësisë së gjyshërve dhe imazhit pothuajse mitik të nënës ka formësuar atë që Anita është sot.

Ndërkohë që në momentin



që iku në Itali, rreth moshës 11 vjeçe filloi era e vërtetë, përballja me një realitet të ri dhe ndryshe. Kur e pyes sesi u përshtat me këtë botë të re, që e kishim parë vetëm nga televizori më thotë se të jetuarit në vendin fqinj në fillim, ishte një proces i dhimbshëm dhe çoroditës, gati si një thyerje ekzistenciale. Nuk ishte vetëm gjuha, ajo teknologji e parë që duhej ta zotëronte për t'u çliruar, por një univers i tërë kodesh kulturore dhe shoqërore që i rrëshqiste ndër duar, një botë e re që ende nuk dinte ta deshifronte. Vetë moderniteti i dukej si një rrjetë e ndërlikuar, e vështirë për t'u përshkruar nga dikush si ajo, që mbarte në zemër një histori tjetër. E megjithatë, ky moment ku gjeti farën e parë të kuptimit: vetëdije e të qenit “tjetër” e shndërroi ndjesinë e përjashtimit në një lente për të dalluar dhe për të vëzhguar. Ishte një barrë që e ndiente mbi supe sa herë që dikush, duke kapur theksin e saj, e pyeste: “Nga je?”. Përgjigjej “shqiptare” dhe ai “Ah!” që përmbante një gjykim, një refuzim. Në ato vite, të ishe shqiptar ishte një vulë, sinonim i përjashtimit, një identitet i shndërruar në dënim. Por, Anita nuk e pranoi kurrë këtë narrativë. I premti vetes se një ditë do të thoshte “Jam shqiptare” me krenari, pa frikë, dhe se do të kontribuonte, qoftë edhe pak, për të thyer atë paragjykim. Nuk ishte një e huaj, ishte një njeri. Dhe

sot e thotë me qartësi: **“Jam shqiptare, Jam italiane, Jam evropiane”**. Nuk ka shpërblime për këtë, vetëm kënaqësia e të treguarit se paragjykimi nuk përcakton asgjë, përveç injorancës së atyre që e ushtrojnë. Tjetri nuk është kurrë armiku; është pasqyra përmes së cilës kuptojmë veten tonë. Kjo vetëdije ka qenë, dhe mbetet, akti politik më i thellë”.

Kur lexojmë mbi njerëz të mëdhenj, shkrimtarë e piktorë, duket sikur fëmijërinë nuk e kanë patur shumë të paqtë. Mendon se është e vërtetë që vuajtja të bën akoma të fortë dhe fëmijëria është pikërisht ajo baza e ndërtimit të asaj që do vij më pas?

Marrëdhënia midis vuajtjes dhe forcës, ashtu si edhe roli i fëmijërisë në formësimin e individit, është një çështje e ndërlikuar që nuk mund të shtrydhet në një të vërtetë të vetme universale. Nga njëra anë, është e pamohueshme se shumë artistë të mëdhenj dhe mendimtarë kanë nxjerrë nga fëmijëria e tyre e trazuar një thellësi vizioni dhe një ndjeshmëri të mprehtë – një lloj alkimie, si të thuash, që e shndërron dhimbjen në krijim. Por nga ana tjetër, ekzistojnë po aq shembuj të rëndësishëm të jetëve të ndërtuara mbi stabilitet dhe mirëqenie, që kanë dhënë fryt mendimi po aq të thellë.

Fëmijëria mund të jetë një-

kohësisht vendi i magjepsjes ose skena e privimit. Ajo që ka rëndësi është mënyra se si këto përvoja – qofshin ato të gëzimit apo të dhimbjes – përpunohen nga individit dhe shndërrohen në mjete të rritjes. Dhimbja, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për të prodhuar madhësi; është përpunimi i asaj përvoje, aftësia për ta kaluar dhe për t'i dhënë kuptim, që bëhet motori i krijimit dhe i zbulimit.

“ Nuk mund të them se të ndihesha e huaj ishte një gjendje e panjohur për mua. Edhe në Shqipëri, në një farë kuptimi, isha një e huaj. Ndjesia e të qenit jashtë vendit, jashtë kohës, ishte diçka që e kisha përjetuar më parë dhe që, në mënyrë paradoksale, më dha një mjet për të deshifruar diskriminimin. Të jesh “tjetër” – fillimisht si fëmijë shqiptare në Itali, më pas si një individ i pezulluar mes botësh – më mësoi se identiteti nuk ndërtohet kundër tjetrit, por përmes tij. “ - thotë sot duke shtuar : **“ Ndihehem italiane, ndihehem evropiane, pjesë e një bashkësie që e përcakton vetveten përmes dialogut, jo përmes kufijve. Pengesat dhe kufizimet u përjashtojnë atyre që i druhen ballafaqimit, atyre që nuk kuptojnë se tjetri nuk është veçse një version i vetvetes, një pasqyrë që reflekton mundësitë tona.**

Nëse do i kthehesh historisë mbrapa do kishe dashur të

“

Ndihem italiane, ndihem evropiane, pjesë e një bashkësie që e përcakton vetveten

përmes dialogut,
jo përmes kufijve.
Pengesat dhe kufizimet u përkasin atyre që i druhen ballafaqimit, atyre që nuk kuptojnë se tjetri nuk është veçse një version i vetvetes, një pasqyrë që reflekton mundësitë tona.

“



ndryshoje ndonjë gjë?

Unë nuk jetoj mes “sikur” dhe “po të ishte”, sepse ato janë hije të kota që na largojnë nga e tashmja. Nuk ia bëj vetes këtë pyetje: kthimi pas në histori nuk është një mundësi, por një iluzion. Historia është ajo që ka qenë, dhe kuptimi i saj zbulohet vetëm në të tashmen, në veprimin tonë këtu dhe tani. Siç shkruante Nietzsche, “duhet ta duash fatin tënd” – edhe kur është i papërsosur, sepse është i vetmi terren mbi të cilin mund të ndërtojmë.

Studimet i mbarove për Filozofi. E gjete veten shpejt në tregun e punës?

Jo, tregu i punës nuk më priti me krahë hapur, dhe nuk u habita. Pavarësisht një formimi akademik të shkëlqyer, u përballa me një sistem të ngurtë, të ngritur mbi logjika marrëdhëniesh që përjashtonin gratë, veçanërisht ato që – si unë – nuk bënin pjesë në rrjetet e konsoliduara të pushtetit. Përballë kësaj, kuptova diçka themelore: nuk mund të prisja hapjen e një dore që askush nuk ishte i gatshëm ta hapte për mua. Duhej ta ndërtoja vetë derën time.

Kështu, shikova përpara, drejt dixhitalit, që asokohe përfaqësonte një kufi të ri, më pak hierarkik, më pak i ngulitur në strukturat tradicionale patriarkale. Në një vend si Italia, ku kapitalizmi ende mbështetet

fuqishëm mbi marrëdhënie familjare dhe të njohjeve, sektori teknologjik ofronte një mundësi për ata që, si unë, kërkonin jo vetëm hapësirë, por edhe autonomi. Dhe zgjodha jo vetëm të marr pjesë, por të zotëroj. Sot jam pjesë e atij 7% të grave në Itali që jo vetëm drejtojnë një kompani, por mbajnë shumicën e aksioneve të saj. Jam sipërmarrëse. Dhe kjo, më shumë se një arritje personale, është



një pozicion politik dhe filozofik. Të jesh sipërmarrëse nuk është një shpërblim, është një akt lirie. Dhe qëllimi im nuk është të jem një përjashtim, por të kontribuoj në krijimin e një bote ku të shohësh një grua në komandë të mos jetë më diçka e jashtëzakonshme, por e natyrshme.

Sot jam themeluese dhe administratore e përgjithshme e Holding Exegesis Srl, një kom-

pani që vepron në sektorin e financës dhe zotëron rreth 20 pjesëmarrje në startup-e inovative, shumë prej të cilave janë tashmë liderë në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Disa prej tyre janë gjithashtu të mbështetura nga subjekte institucionale dhe kompani të listuara në bursë. Një tjetër, Coderblock, me qendër në Itali dhe Miami, po punon me sukses në tregun amerikan.

Sa i përket filozofisë, mund të them se nuk e kam braktisur kurrë. Gjithmonë kam besuar se është filozofia, me aftësinë e saj për të pyetur mbi kuptimin dhe qëllimin, ajo që i tregon teknologjisë drejtimin që duhet të ndjekë. Teknologjia pa filozofi është e verbër; filozofia pa teknologji, e pafrytshme. Udhëtimi im nuk ishte një tradhti, por një urë që lidh dy botë që i përkasin njëra-tjetrës më shumë sesa duket.

Mendon se Inteligjenca Artificiale do arrij të mbivendoset edhe mbi artin e së bukurës?

Inteligjenca artificiale mund të riprodhojë, imitojë dhe madje të tejkalojë njeriun në disa aftësi teknike, por arti dhe bukuria i përkasin një sferë që nuk është thjesht funksionale: ato janë fryt i qëllimit dhe i përvojës njerëzore. Arti nuk është vetëm krijim, por shprehje e një brendësie që përballlet me misterin e të jetuarit.

IA mund të gjenerojë imazhe,

tinguj apo tekste që ndjekin rregulla estetike, por nuk mund të njohë kuptimin e asaj krijimi, as të ndiejë dëshirën, mahnitjen apo marramendjen që e bëjnë artin të vërtetë. Prandaj, jo, Inteligjenca Artificiale nuk do të mund të sheshojë kufirin mes artit dhe bukurisë, por padyshim do të zgjerojë mjetet me të cilat ne eksplorojmë dhe rimendojmë këto koncepte, duke na vënë përballë pyetjeve të reja mbi kuptimin e të qenit njeri. Dhe ndoshta, pikërisht në këtë dialog midis njerëzores dhe artificiales, do të zbulojmë forma të reja të bukurisë.

Një përpjekje tjetër e jotja është dhe angazhimi yt politik si e para shqiptare në parlamentin italian...

Pas vlerësimit në Londër si një nga 50 gratë më me ndikim në Evropë për inovacion, në kuadër të "Inspiring 50," mora një telefonatë nga nënsekretari Bruno Tabacci, i cili më kishte lexuar në **Corriere della Sera**. Më propozoi të kandidoja për Parlamentin pas rrëzimit të qeverisë Draghi. E dija që nuk do të zgjidhesha – ia thashë: "Nuk do të kaloj, por pranoj." Pranova, sepse ajo kandidaturë ishte një akt simbolik: **të ishe grua e parë shqiptare e kandiduar për Parlamentin italian do të thoshte të afir-**

moje një vizion të vërtetë për përfshirje dhe hapje.

Si e sheh politikën shqiptare nga jashtë? Marrëveshjen Rama – Meloni për emigrantët e huaj në kampin e Gjadrit dhe pozicionin e Shqipërisë në arenën ndër-



kombëtare?

Politika shqiptare, kur shihet nga jashtë, pasqyron ende kompleksitetin e një vendi që, pas tridhjetë vitesh tranzicioni, kërkon një rrugë drejt stabilitetit dhe vetëvendosjes. Marrëveshja midis Ramës dhe Melonit për menaxhimin e migrantëve të huaj në kampin e Gjadrit e tregon këtë: një zg-

jedhje që, e parë nga dy perspektiva të ndryshme, ofron lexime krejt të kundërta.

Si italiane, e shoh këtë marrëveshje të pafavorshme për Italinë. Jo vetëm për implikimet etike dhe politike, por edhe sepse Meloni tani përballet me një hetim të prokurorisë për dëme të supozuara financiare lidhur me këtë investim në Shqipëri. Është një strategji që, ndonëse maskohet si një zgjidhje praktike, duket se transferon përgjegjësi në vend që t'i zgjidhë ato, duke zhvendosur peshën e kontradiktave europiane mbi çështjen e migracionit përtej kufijve të saj.

Si shqiptare, nga ana tjetër, e njoh në zgjedhjen e Ramës një lëvizje strategjike të zgjuar. Rama është një komunikator i shkëlqyer politik, i aftë të shndërrojë një krizë në një mundësi për të forcuar rolin e Shqipërisë në skenën ndërkombëtare. Megjithatë, kjo marrëveshje

nxjerr në pah edhe pozicionin marginal të vendit në raport me dinamikën europiane. Shqipëria rrezikon të kthehet, në diskursin politik europian, në një shportë ku derdhen përgjegjësitë, dhe kjo nuk mund të jetë e pranueshme. Politika shqiptare duhet të dalë nga logjika e thjeshtësisë së përshtatjes ndaj presioneve të

jashtme dhe të përqafojë një vizion të mirëfilltë, të orientuar drejt së ardhmes.

Së fundmi dhe shkrimtare, botuese e librit “Le favole del comunismo” një dualitet personazhesh që pritet të vij së shpejti në gjuhën shqipe. Para se ta kemi në duar a mund të na thyesh kuriozitetin është një autobiografi apo një krijim i yti? Cilat janë përrallat e komunizmit?

Nuk ka rëndësi të dihet nëse “Le favole del comunismo” janë fantazi apo realitet, nëse mbartin gjurmë autobiografie apo jo. Siç shkruante Italo Calvino, “Letërsia është e nevojshme vetëm kur zbulon atë që lexuesi nuk e dinte se e dinte. Vlera e një historie nuk qëndron tek autori që pasqyrohet në të, por tek lexuesi që e gjen veten aty.”

Nuk më pëlqen leximi autobiografik, sepse shpesh reduktohet në propagandë politike ose në një ushtrim narcisizmi letrar: një autor që shkruan për t’u pasqyruar, për të vetë-emancipuar veten, është një autor që zgjedh sterilitetin. Është thjesht një masturbim intelektual. Letërsia e vërtetë, përkundrazi, vihet në shërbim të tjetrit, i hapet botës dhe zhvishet nga vetvetja. Pikërisht aty qëndron vlera e saj, dhe pikërisht aty përpiqen të pozicionohen edhe “Le favole del comunismo”. Nuk ka rëndësi autori; ka rëndësi ajo që

mbetet.

Në nëntor të vitit që shkoi more një mision shumë fisnik, një projekt edukativ në pesë shkollat e Tiranës (nga moshë 10 – 13 vjeç) Pse zgjodhe këtë grupmoshë dhe çfarë gjete në sytë e tyre?

Me mbështetjen e Institutit Bruno Leoni, ky projekt përfaqëson për mua një kthim tek rrënjët. Zgjodha grupmoshën 10-13 vjeç, sepse është pikërisht ajo fazë kur formohet identiteti i brishtë, por i mbushur me mundësi. Është moshë që më përket: lashë Shqipërinë në moshën 11 vjeç e gjysmë, dhe në sytë e këtyre fëmijëve, në pesë shkolla dhe dhjetë klasa, pashë shumë versione të vetes sime.

Projekti përdor një libër komik si mjet edukimi për të shpjeguar çfarë do të thotë të jetosh në një demokraci. Përmes historive të thjeshta dhe tërheqëse, trajtojmë tema si burokracia, vlera e të menduarit të pavarur dhe drejtësia sociale, duke i ftuar fëmijët të reflektojnë me kokën e tyre.

Nuk bëhet fjalë për t’u mësuar atyre gjuhën e të rriturve, por për t’i lënë të eksplorojnë, përmes lojës dhe rrëfimit, një botë ku ëndrrat kanë hapësirë të rriten.

Çfarë është dashuria për ty?

Dashuria, për mua, është

ndërtim. Është gjesti i duruar dhe i pandërprerë i ndërtimit të diçkaje që ende nuk ekziston, por që merr formë vetëm nëpërmjet reciprocitetit. Është të dish të presësh, të mbetesh i palëkundur në vendimet e tua pa humbur fleksibilitetin për të pranuar ndryshimin. Dashuria është besnikëri: jo vetëm ndaj tjetrit, por mbi të gjitha ndaj vetes, ndaj idealeve dhe vlerave të tua, pa të cilat dashuria bëhet e zbrazët.

Dashuria është gjithashtu pranimi: të pranosh tjetrin në gjithë kompleksitetin e tij, pavarësisht gjithçkaje, dhe të pranosh veten në papërsosmërinë tënde. Është një gjendje që duket e paarsyeshme – siç shkruante Albert Camus, “Zemra ka arsytet e saj që arsyeja nuk i njeh” – por pikërisht në këtë paarsyeshmëri zbulohet thelbësorja. Është toka mbi të cilën mbështetet vetë jeta, energjia që sfidon racionalen, por që i jep kuptim qenies tonë në botë.

Dashuria, në fund, është një paradoks: është të qëndrosh i palëvizshëm dhe, në të njëjtën kohë, të dish të ndryshosh; është të jesh besnik dhe, njëkohësisht, të pranosh transformimin. Nuk është pronësi, por krijim, një vetë-rikrijim i vazhdueshëm. Është lidhja që na mban njerëzorë, të cënueshëm, por edhe të aftë për t’u përballur me të panjohurën, sepse të duash është një angazhim i madh, më i vështiri:

është një punë e përditshme mbi veten dhe për tjetrin. Dashuria, për mua, është pikërisht kjo: forca dhe guximi për të vazhduar të ndërtosh.

Dhe drejt mbylljes të kësaj interviste Anita thotë se super-fuqia e saj është inteligjenca, edhe pse preferon ta lërë të flasë përmes rezultateve, sesa ta shpalli vetë. Këmbëngulja e ka çuar përpara, por është zgjuarsia, ajo që e ka mundësuar të zgjedh kush do të jetë dhe cilat rrugë duhet të ndjek. - “ Mбай mend kur një shkrimtar i njohur italian më pyeti, me një singleritet pothuaj brutal, nëse do të më kishte vënë re ndonjëherë pa bukurinë time. Pyetja, në dukje e drejtpërdrejtë, mbante brenda një paragjykim të vjetër: që pamja është një pasaportë për të hyrë, por jo për të qëndruar. Dhe vërtet, ato dyer që u hapën lehtësisht, u mbyllën po aq shpejt, sepse nuk isha e gatshme të paguaja çmimin e një kompromisi me veten.”

Nuk jam parë kurrë e bukur. Si fëmijë, në Shqipëri, fiziku im ishte shkak për tallje: “mace, buzëvije, hundë shumë e vogël”. Sot, ironikisht, shoh njerëz që ndjekin atë model përmes kirurgjisë plastike. Por unë, qysh atëherë, kisha zgjedhur të kultivoja diçka tjetër. Bukurinë, nëse ndonjëherë ka qenë një avantazh, e kam përjetuar gjithnjë me distancë: jo si një identitet, por si një

mundësi që refuzoja t’ia lija në dorë të tjerëve.

“ Bukuria mund të hapë një rrugë, por vetëm inteligjenca të lejon ta ndërtosh atë. Super-fuqia ime nuk është të tërheq vëmendje, por të zgjedh. Dhe çdo derë e mbyllur ka qenë një akt lirie, një refuzim për të qenë një figurant në botën e dikujt tjetër. “ – përfundon ajo.



A woman with brown hair and blue eyes, smiling, wearing a black turtleneck sweater. She is standing against a light gray background. Her shadow is cast on the wall behind her to the left.

**Dashuria, në fund, është
një paradoks: është të
qëndrosh i palëvizshëm
dhe, në të njëjtën kohë,
të dish të ndryshosh;
është të jesh besnik dhe,
njëkohësisht, të pranosh
transformimin.**
